KËRKESË
Nr.59/8, datë 3.2.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Drejtësisë shpall kërkesën Për shpronësimin, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme, pronë private (tokë arë), që preket si rezultat i ndërtimit të Qendrës së Riintegrimit për të Mitur, Kavajë.

Subjekti kërkues është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilit preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Drejtësisë).

PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE NË QENDRËN E RIINTEGRIMIT PËR TË MITUR, KAVAJË

Nr.	**Emri, mbiemri**	**Sip/tokë arë**	**Çmimi i objektit m^2 (lekë)**	**Vlera në lekë**
1.	Bashkëpronarët e familjes Tuka	476 m^2	15 290 lekë	7 278 040 lekë

Vlera totale e shpronësimit është 7 278 040 (shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyzetë) lekë.

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, vlera e shpenzimeve të procedurës së shpronësimit do të përballohet nga subjekti kërkues i shpronësimit, që është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.